

 <b>Tel: + 355 4 2 269097</b> <b>Fax : + 355 4 2 269325</b> <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b>	<b>Politika e moskonformiteteve</b>	<b>Kodi DA-PO-013</b>
		<b>Rishikimi nr 5</b> <b>Dt: 28.06.2024</b>
		<b>Faqe 1 nga 4</b>

## Qëllimi

Ky dokument përcakton politikën e DPA në lidhje me moskonformitetet dhe komentet e gjetura gjatë vlerësimit të kompetencës teknike të organeve të vlerësimit të konformitetit, analizën e thelluar të shkaqeve si dhe veprimet që merr DPA në rastin e moskonformiteteve.

## Referencat

ISO/IEC 17011:2017, paragrafi 7.6.6 “Kërkesa të përgjithshme për organizmat e akreditimit që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit”  
 Procedura DA-PT-001 “Procedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit të akreditimit”.  
 Politika e akreditimit, DA-PO-002.

## Fusha e Zbatimit.

Kjo politikë zbatohet për të gjitha moskonformitetet e gjetura gjatë vlerësimit të kompetencës teknike të organeve të vlerësimit të konformitetit që kanë aplikuar për akreditim apo janë akredituar nga DPA.

## Fjalori


Moskonformitet është dështimi në plotësimin e një ose disa kriterëve të vendosura për akreditimin.

Koment është një gjetje kur kriteret e vendosura janë plotësuar por ka mundësi për përmirësim.

## 1. NATYRA E MOSKONFORMITETEVE

Kur gjatë vlerësimit të kompetencës teknike të një organi të vlerësimit të konformitetit është konstatuar se një ose disa kriteret për akreditim nuk janë përmbushur, DPA formulon një ose disa moskonformitete. Mungesa e procedurave të dokumentuara, mos kryerja e proceseve nga OVK në përputhje me procedurat e përcaktuara nga vetë ajo do të konsiderohet gjithashtu moskonformitet. Moskonformiteti mund të identifikohet edhe në rastet kur OVK nuk respekton rregullat e vendosura nga DPA.

Moskonformiteti mund të identifikohet si rezultat i:

 <b>Tel: + 355 4 2 269097</b> <b>Fax : + 355 4 2 269325</b> <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b>	<b>Politika e moskonformiteteve</b>	<b>Kodi DA-PO-013</b>
		<b>Rishikimi nr 5</b> <b>Dt: 28.06.2024</b>
		<b>Faqe 2 nga 4</b>

- Dokumentacioni i OVK nuk është në përputhje me kërkesat e standardit.
- Personeli i OVK-së nuk ndjek procedurat e dokumentuara.
- Personeli i OVK demonstron që nuk është kompetent për punën që ai kryen ose që është autorizuar të kryejë.
- Procedurat operative të tilla si psh. metodat e matjeve dhe të testimit, gjurmueshmëria në matje, vlefshmëria e metodës etj, kanë mungesa të vlefshmërisë teknike
- Mos funksionimi i sistemit të menaxhimit të OVK-së
- OVK-ja nuk plotëson rregullat e vendosura nga DPA.

Komentet janë gjetje të formuluar nga DPA mbi mundësitë për përmirësim të aktivitetit të vlerësimit të konformitetit që organi i vlerësimit të konformitetit kryen brenda programit të akreditimit.

## **2 VEPRIMET QË MERREN NGA DPA SI PASOJË E MOSKONFORMITETEVE**

Nëse menaxheri i dosjes apo grupi i vlerësimit konstaton moskonformitete gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, ato formulohen në format përkatëse, DA-FO-006 dhe DA-FO-007.

Nëse grupi i vlerësimit konstaton moskonformitete gjatë vizitave vlerësuese apo vizitave paravlerësuese, në takimin mbyllës të vizitës (në vend apo në distancë) ato duhet të formulohen sipas formës DA-FO-003 dhe duhet t'i paraqiten organit të vlerësimit të konformitetit. Një kopje e moskonformiteteve i dorëzohet OVK së vlerësuar. Nëse moskonformiteti është formuluar pas vizitës, ai duhet të jetë i shkruar në raportin e vlerësimit. Forma DA-FO-003 për moskonformitetin e formuluar pas takimit mbyllës i dërgohet OVK së bashku me raportin e vlerësimit dhe shpjegimin përkatës.

Në rastet kur OVK refuzon të nënshkruajë moskonformitetin e konstatuar nga grupi vlerësues gjatë vizitës vlerësuese ose paravlerësuese, Drejtori i drejtorisë përkatëse do të vendosë nëse gjetja është moskonformitet apo jo, apo formulimin e saktë të gjetjes. Drejtori i Drejtorisë mund të kërkojë edhe mendimin e grupit teknik përkatës.

Për cdo moskonformitet të konstatuar gjatë vizitës vlerësuese ose të evidentuar në raport, OVK duhet të kryej analizën e thelluar të shkaqeve, veprimet që ajo ka marrë ose planifikon të marrë për zgjidhjen e moskonformitetit dhe afatin kohor për ndërmarrjen e veprimeve. Grupi i vlerësimit analizon analizën e shkaqeve dhe veprimet e propozuara nga OVK-ja. Nëse analiza e kryer dhe veprimet e propozuara nuk janë të majftueshme

 <b>Tel: + 355 4 2 269097</b> <b>Fax : + 355 4 2 269325</b> <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b>	<b>Politika e moskonformiteteve</b>	<b>Kodi DA-PO-013</b>
		<b>Rishikimi nr 5</b> <b>Dt: 28.06.2024</b>
		<b>Faqe 3 nga 4</b>

dhe të përshtatshme, grupi i vlerësimit i kërkon OVK ri-kryerjen e analizës së shkaqeve dhe propozimin e veprimeve përkatëse bazuar në analizën e re. OVK është e detyruar të dërgojë të gjitha rregjistrimet e veprimeve të ndërmarra në DPA. Përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria e veprimeve të ndërmarra nga OVK do të vlerësohen nga grupi i vlerësimit ose nëpërmjet shqyrtimit të regjistrimeve ose në një vizitë vlerësuese ose në një kombinim të të dyjave. Përpara dhënies së rekomandimit për akreditimin në rastin e akreditimit fillestar ose të zgjerimit apo të rekomandimit për mirëmbajtjen e akreditimit të gjitha moskonformitetet e gjetura duhet të zgjidhen. Moszgjidhja e moskonformiteteve në akreditim fillestar ose zgjerim çon në refuzimin e kërkesës për akreditim ose në mos zgjerim të programit të akreditimit, Moszgjidhja e moskonformiteteve të evidentuara në vizita mbikëqyrëse (të planifikuar apo të paplanifikuar) çon në reduktimin ose pezullimin ose tërheqjen e akreditimit.

Grupi i vlerësimit mund të formulojë edhe komente në fushat për përmirësime të mundshme të cilat duhet ti dorëzohen organit të vlerësimit të konformitetit ose në takimin mbyllës ose të shkruhen në raportin e vlerësimit. Në formulimin e komenteve, grupi i vlerësimit duhet të tregohet i kujdesshëm që të mos japë rekomandime për zgjidhje specifike. Në lidhje me komentet e formuluar, DPA nuk pret që OVK të dorëzojë në DPA rregjistrimet e veprimeve, por ato do të vlerësohen në vizitat e ardhshme si mundësi për përmirësim.

### **3 AFATET KOHORE PËR ZGJIDHJEN E MOSKONFORMITETEVE**

Për zgjidhjen e moskonformiteteve, DPA ka përcaktuar afatet kohore përkatëse.

Në rastin e moskonformiteteve të gjetura gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, afati maksimal për zgjidhjen e tyre është 6 muaj.

Në rastin e moskonformiteteve të gjetura gjatë vizitave paravlerësuese, afati maksimal për zgjidhjen e tyre është 6 muaj.

Në rastin e moskonformiteteve të gjetura në vizitat vlerësuese për akreditim fillestar ose zgjerim, afati maksimal për zgjidhjen e tyre është 5 muaj.

Në rastin e moskonformiteteve të gjetura në vizitat mbikëqyrëse ose mbikëqyrëse ku përfshihet edhe vlerësimi për zgjerimin e programit të akreditimit, afati maksimal për zgjidhjen e moskonformiteteve është 2 muaj.

OVK mund të kërkojë, vetëm një herë, zgjatjen e afatit për zgjidhjen e moskonformiteteve të gjetura gjatë vizitës vlerësuese. Zgjatja duhet të kërkohet me shkrim duke përmendur arsyet e shtyrjes. Zgjatja e afatit miratohet nga Drejtori i

 <b>Tel: + 355 4 2 269097</b> <b>Fax : + 355 4 2 269325</b> <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b>	<b>Politika e moskonformiteteve</b>	<b>Kodi DA-PO-013</b>
		<b>Rishikimi nr 5</b> <b>Dt: 28.06.2024</b>
		<b>Faqe 4 nga 4</b>

Drejtoria e përkatese nese ka arsye objektive. Zgjatja nuk mund te jetë me shumë se një muaj, nese është e justifikuar.

Moszgjidhja e moskonformiteteve në afatin e përcaktuar në rastin e akreditimit fillestar ose zgjerimit çon në refuzimin e aplikimit për akreditim ose refuzimin e akreditimit për një aktivitet të caktuar të vlerësimit të konformitetit ose moszgjerim të programit të akreditimit. Mos zgjidhja e moskonformiteteve në afatin e përcaktuar në rastin e vizitave mbikëqyrëse (të planifikuara ose të paplanifikuara) çon në reduktimin ose pezullimin ose tërheqjen e akreditimit.

**Data: 28.06.2024**

**Drejtori i Përgjithshëm**

**Pranvera FAGU**